

AKTIVITETI I SHËRBIMIT LIGJOR FALAS TIRANË
(TIRANA LEGAL AID SOCIETY), TLAS, 2022

Viti 2022 ishte një vit i suksesshëm për Shërbimin Ligjor Falas (TLAS). Kjo u shpërfaq me një numër më të lartë klientësh të ndihmuar në çështje të ndryshme ligjore. Gjithashtu, me punën tonë advokuese, hulumtuese dhe studimore, patëm mundësi të ndërmerrnim më shumë iniciativa për të rritur ndërgjegjësimin publik mbi të drejtat e njeriut dhe ndryshimet dhe përmirësimin e legjislacionit. TLAS vazhdoi të punojë përgjatë këtij viti me një staf të përkushtuar dhe të motivuar, të cilët ishin të angazhuar për të ofruar ndihmë juridike të cilësisë së lartë për klientët.

Në vitin 2022, TLAS vazhdoi të ofronte ndihmë ligjore falas për klientët në nevojë. Me një numër të madhtë rasteve të pranura (1286 raste në total), stafi i TLAS u përkushtua për të siguruar që çdo klient në nevojë, të kishte akses në një avokat të specializuar në fushën e tyre. Në total, TLAS shënoi një rritje prej 6.6% në numrin e klientëve të ndihmuar në krahasim me vitin 2021.

Gjatë vitit 2022, TLAS ishte një aktor aktiv në procesin e përmirësimit të sistemit të drejtësisë në vendin tonë. Megjithatë, ndryshimet pozitive dhe negative të Reformës në drejtësi kanë sjellë një ndjenjë mosbesimi dhe pesimizmi te qytetarët për funksionimin e sistemit të drejtësisë dhe performancën e aktorëve të tij institucional. Megjithatë, kjo organizatë ka vazhduar të ofrojë shërbime ligjore falas, duke asistuar drejtpërdrejt 1286 çështje ligjore për të përkrahur fëmijët, të papunët, personat me aftësi të kufizuara, pensionistët, grupin LGBTI, minoritetet dhe familjet në nevojë. Më shumë se 98.5% e rasteve janë finalizuar me sukses në favor të përfituesve të shërbimit, duke ndihmuar në aksesin e tyre në drejtësi dhe në programet sociale, si dhe në përmirësimin e situatës së tyre ekonomike.

Gjatë 2022, TLAS ka synuar përfaqësimet ligjore strategjike si përpara administratës shtetërore ashtu dhe para gjykatës, si edhe forcimit të partneriteti efektiv mes strukturave shtetërore, me NGO-të partnere apo përfaqësuesit në nivelin lokal në mënyrë që të plotësohet shërbimi ndaj shtresave apo individëve më të margjinalizuar, mbrojtjes së të drejtave të tyre përmes

- **Përcaktimit** me përparësi të llojeve të shërbimeve për fëmijët, familjet vulnerabël dhe qytetarët e tjerë të varfër;
- **Përmirësimit** të aftësive të klientëve për të zgjidhur problemet ligjore nëpërmjet trajnimit individual dhe në grup me drejtues ose përfaqësues të komunitetit, nëpërmjet ofrimit të formularëve të gatshëm e të lehtë për t'u përdorur;
- **Identifikimit** të çështjeve ligjore përmes aktivizimit të Rrjeteve të bashkëpunimit në nivel lokal, përdorimit të teknologjisë dhe Portalit të posaçëm të TLAS, i cili jo vetëm evidenton kërkesat e qytetarëve por synon t'i orientojë e asistojë ato drejt zgjidhjes;
- **Zgjerimit** të strukture së tij dhe partnerëve apo aktorëve të tjerë qeveritarë dhe joqeveritarë për të ndërtuar besimin te individët në nevojë dhe krijuar një realitet tjetër në funksion të zhvillimeve të mëtejshme të demokracisë në Shqipëri;
- **Rritjes së kapaciteteve** të profesionistëve, seminareve të trajnimit, ëorkshopeve dhe tryezave të shumta në të gjithë vendin;

- **Ofrimit të shërbimeve** ligjore mobile, aktiviteteteve të street laë, shërbimeve hotline, përdorimit të teknologjisë është bërë e mundur që të përfitojnë individë vulnerabël në të gjithë territorin e vendit;
- **Nismave** për hartimin e udhëzuesve, komentareve apo protokolleve të nevojshme për të mbështetur zbatimin efektiv të legjislacionit;

Sa i përket, financimit i cili mbetet çdo vit një sfidë e vërtetë, TLAS ka arritur të sigurojë mbështetje financiare dhe të jetë eficient në shërbimet e tij, bazuar në shumëllojshmërinë e formave të ofrimit, në cilësinë e lartë dhe me kosto të ulët. Pikërisht këtë model po e promovojmë jo vetëm në Tiranë por edhe në të gjithë territorin e vendit. Synimi i TLAS në këtë analizë vjetore është rritja e aksesit në drejtësi dhe në programet ekonomike e sociale, ngritja e kapaciteteve dhe nxitja e profesionistëve të fushës së arsimit, shëndetësisë, gjëndjes civile, shërbimit social shtetëror, për t'u përfshirë në mënyrë më të interesuar dhe koordinuar në funksion të zgjidhjes së halleve të atyre që kanë më shumë nevojë.

Së fundmi, TLAS-i vlerëson në mënyrë të veçantë, kontributin, përkushtimin dhe angazhimin e ekspertëve, anëtarëve të stafit dhe vullnetarëve. Një falenderim shumë i veçantë i drejtohet donatorëve që kanë mbështetur programin e TLAS gjatë 2020 si **UNDP, UNHCR, COE, Dutch Embassy, EU/EIDHR, Ambasada e Amerikane, etj.**

FUSHA E LIGJIT NË OFRIMIN E SHËRBIMEVE

TLAS vazhdoi gjatë vitit 2022 të ofrojë shërbime ligjore për çështjet civile, administrative, familjare dhe të punës si dhe për rastet e shkeljes së të drejtave të njeriut; në formën e këshillimit dhe të përfaqësimit si në organet administrative edhe në ato gjyqësore. Shërbimi Ligjor Falas i TLAS është i fokusuar tek familjet më të varfra, tek fëmijët vulnerabël, pensionistët, grupi LGBTI, individë me aftësi të ndryshme dhe kryesisht duke synuar përfshirjen e tyre sociale.

Numri total i përfituesve të drejtpërdrejtë nga Shërbimi Ligjor Falas Tiranë, TLAS, gjatë 2022 ka qënë **1286** klientë, dhe numri total i të gjithë përfituesve të drejtpërdrejtë gjatë 23 viteve të funksionimit të Shërbimit Ligjor Falas, TLAS, ka arritur shifrën **30196** klientë1. Përqindja e shkallës së suksesit të çështjeve të përfaqësuara përpara gjykatave dhe strukturave administrative gjatë 2022 është si mëposhtë:

Lloji i shërbimit të ofruar në 2022	Numri i rasteve	Mbyllur në favor të klientit
Përfaqësime në gjykatë (ndihmë juridike dytësore)	305	98 %
Përfaqësime në administratë (ndihmë juridike parësore)	590	94 %
Shërbyer me ndihmë parësore dhe kliniks	391	n/a
Total	1286	

Mëposhtë gjeni diagramën progresive të përfituesve të drejtpërdrejtë të shërbimeve ligjore falas vit pas viti që nga themelimi i TLAS:




Tabela jep ngarkesën mujore të stafit që ofron shërbime ligjore për një total prej 1286 përfitues të drejtpërdrejtë gjatë vitit 2022:

Ndjekur	Status	Jan	Shk	Mar	Pri	Maj	Qer	Korr	Gush	Shta	Tet	Nen	Dhje
Avokatët	Hapur	176	203	227	267	294	308	334	342	363	377	398	405
	Mbyllur	10	15	20	25	35	46	55	69	105	143	200	235
	Aktive	166	188	207	242	259	262	279	273	258	234	198	170
Paraligjorët	Hapur	173	228	359	435	502	568	616	636	686	769	840	881
	Mbyllur	42	93	205	250	345	415	465	500	550	637	720	791
	Aktive	131	135	154	185	157	153	151	136	136	132	120	90
Total	Hapur	349	431	586	702	796	876	950	978	1049	1146	1238	1286
	Mbyllur	43	108	225	275	380	461	520	560	655	780	920	1026
	Aktive	306	323	361	427	416	415	400	418	394	366	318	260

Në fund të muajit Dhjetor 2022, rezulton se janë ende në proces 170 çështje gjyqësore dhe 90 çështje administrative. Arsyeja pse nuk ka qenë e mundur të finalizohen të gjitha çështjet janë të ndryshme: Lidhur me çështjet gjyqësore, së pari çështjet gjyqësore që janë hapur në tremujorin e fundit, nuk kanë asnjë mundësi të mbyllen në këtë afat; së dyti reforma në drejtësi, reformimi i gjyqtarëve ka sjellë reduktimin e numrit të tyre, gjë që ka shkaktuar zvarritje dhe zgjatje të kohës së parashikuar për të vecanta; së treti një çështje gjyqësore e pezulluar për shkak se është përjashtuar gjyqtari nga vettingu, hidhet në short nga e para edhe pse janë realizuar seanca të mëparshme të cilat kanë qenë drejt mbylljes; Çështjet administrative nuk janë aq problematike edhe pse janë mbartur 90 të tilla, vetëm se numri i përfituesve aplikantë për ndihmë juridike parësore në dy muajt e fundit të vitit ka qenë i madh dhe sigurimi i dokumentave të nevojshme kërkon kohën e duhur.

Lloji i çështjeve gjyqësore 2022	Total
Regjistrime lindjesh	389
Pavlefshmëri Akti Lindje, Martese, Vdekje, korigjim material, Emri, Mbiemri, Datëlindje, Vendlindje	91
Zgjidhje Martese	66
Kujdestari	168
Njohje atësie, amësie, Kundërshtim atësie, amësie	155
Stehim me qira dhe sociale/ asistence sociale	218
Shpërblim dëmi, heqje zotësie për të vepruar, pension, interseks	199
Totali për vitin 2022	1286


Nga 305 çështje që janë ndjekur në rrugë gjyqësore nga avokatët e TLAS gjatë Vitit 2022, 170 prej tyre nuk janë mbyllur ose finalizuar brenda këtij harku kohor. Çështjet hapen sipas përkatësisë së vend banimit të përfituesve, duke i depozituar kërkesat në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor në të gjithë vendin, dhe rezulton që një numër i vogël prej tyre ankimohen në shkallët e tjera të gjyqësorit. Konkretisht nga viti 2022 janë mbartur 170 çështje të hapura në proces, nga të cilat vetëm një çështje është në Gjykatën e Lartë, një çështje gjykatën e Apelit Administrativ, dy në Gjykatën e Apelit dhe tre çështje janë në Gjykatën e Të Drejtave të Njeriut në Strasburg.

Vështirësitë e punës me gjykata janë ndjerë gjatë vitit 2022:

- për shkak të vettingut, gjykatat nuk kanë punuar me kapacitet të plotë stafi, kanë munguar në mënyrë të ndjeshme gjyqtarët;
- ndryshimeve të legjislacionit dhe në veçanti nga të Kodit të Procedurës Civile, i cili nga gjyqtarë të ndryshëm është interpretuar në mënyra të ndryshme, duke shtuar burokracinë, pushimin shpesh të pajustificuar të çështjeve, të gjitha në kurriz të kohëzgjatjes së çështjeve, të rritjes së kostove për paraqitjen e përsëritur të provave dokumentave të kërkuara, kostove të udhëtimeve dhe humbjes së kohës për finalizimin e çështjeve delikate që kanë të bëjnë me interesin më të lartë të fëmijëve, etj.

Për të parë se cilat kategori vulnerabël kanë përfituar nga shërbimet ligjore falas të TLAS gjatë vitit 2022, po japim të dhënat në tabelë dhe diagramën si mëposhtë:


Grupet përfituese	Ndjekur nga paraligjorët	Ndjekur nga Avokatët	Total
Fëmijë	399	50	389
Gra kryefamiljare	160	134	294
Persona me aftësi ndryshe	6	3	9
Të papunë	207	146	353
Pensionist	49	3	52
Familje të varfra	120	69	189
Total: 2022	881	405	1286



Numri i përfituesve sipas llojit të çështjes gjatë 2022 në tabelë dhe në diagramë parqiten si mëposhtë:

Llojet e Rasteve	Paraligjor	Avokat	Total
Regjistrim Lindje	339	50	389
Regjistrime civile: korrigjime të dhenash, martesë, pavlefshmëri aktesh	69	22	91
Zgjidhje martese	41	127	168
Kujdestari	10	56	66
Kundërshtim atësie/mëmësie - Njohje atësie/mëmësie	45	110	155
Stehim me qera dhe sociale/ asistence sociale	218	0	218
Shpërblim dëmi, heqje zotësie për të vepruar, pension, të drejtat e njeriut, etj.	159	40	199

Total: 2022	881	405	1286
-------------	-----	-----	------



Pas 23 vitesh aktivitet dhe eksperiencë në fushën e ofrimit të shërbimeve ligjore falas, TLAS është sa i njohur edhe po aq i kërkuar nga përfituesit, nga partneret dhe antarët e rrjetit të krijuar në zonat e targetuara dhe ndërhyrjes në të gjithë territorin e vendi në përputhje me projektet e mbështetura nga donatorët tanë. Bashkëpunorët tanë dhe përfituesit e drejtpërdrejtë tashmë janë të mirëorientuar për të përdorur telefonin pa pagesë të zyrës, aksesuar adresën në Tiranë, drejtuar emaille të drejtpërdrejta por edhe përmes faqes së internetit dhe Portalit të TLAS të dedikuar për këtë qëllim.

Gjatë vitit 2022 pati disa burime referimesh dhe rekomandimesh në TLAS nga partnerë apo rrjeti i ndërtuar tashmë i bashkëpunimit me aktorë të interesuar dhe organizata komunitare nga i gjithë vendi:

	Burimet e referimit të rasteve/përfituese në TLAS gjatë 2022	Numri Përqindja
1	Zyrat e Gjendjes Civile	305 = 24%
2	Njesitë e mbrojtjes së fëmijëve/CPU	207 = 16%
3	Klient direkt	404 = 31%
4	OJF/Organizata me bazë komunitare	67 = 5%
5	Shërbimi Social	45 = 3%
6	Web/Portal/Email	102 = 8%
7	Netëork/LAN	156 = 12%
	Nr. Total i përfituesve të drejtpërdrejtë	1286 ose 100 %

Objektivat e përcaktuara nga TLAS për 2022 janë arritur në përputhje me kontratat e nënshkruara me donatorët, edhe pse zhvillimet dhe ndryshimet e diktura nga reformat e ndryshme të ndërrmarra kudo nga qeveria shqiptare si në sistemin e ekonomisë, atë social, territorial apo të drejtësisë kanë qenë intensive, me efekte të drejtpërdrejta dhe të paparashikuara për jetët e familjeve apo individëve vulnerabël.

Përsa i përket objektivit 2, të rritjes së ndërgjegjësimit të grupeve në nevojë dhe të aktorëve që ofrojnë shërbime ndaj tyre, TLAS ka zbatuar një sërë aktivitete të rëndësishme. Organizimi tradicional shumë vjeçar dhe i sukseshëm i TLAS i aktiviteteve street laë, ka qenë më intensiv se viti paraardhës nga ku, aktivitetet në terren i reduktuam si shkak i masave të Covid-19.

2/1 Gjatë vitit 2022 janë zhvilluar nga grupi i studenteve të TLAS disa vizita si mëposhtë :

NR	Vendi: njësiti administrative dhe bashkitë	Data	Numri i qytetareve të takuar	Numri i publikimeve të shpërndara
1	Fier	08.02.2022	82	34
2	Berat	17.02.2022	75	30
3	Elbasan	22.02.2022	64	32
4	Berat	24.02.2022	78	35
5	Elbasan	16.03.2022	87	45

6	Elbasan	24.03.2022	71	57
7	Berat	31.03.2022	78	64
8	Elbasan	04.04.2022	85	59
9	Fier	16.05.2022	54	22
10	Berat	18.05.2022	67	34
11	Tirane	18.10.2022	39	42
12	Tirane	20.10.2022	64	49
13	Tirane	08.11.2022	42	57
TOTALI	13		886	560

2/2 Trajnime të ofruara nga ekspertët e TLAS gjatë 2022 për 391 pjesëmarrës sipas tabelës mëposhtë, përfitues kanë qenë anëtarë të rrjeteve të bashkëpunimit të TLAS nga strukturat lokale dhe partnere të shoqërisë civile si Shërbimet Sociale, Njesitë për mbrojtjen e fëmijëve, punonjës të gjendjes civile, të institucioneve të arsimit, shëndetësisë, policisë dhe organizatave me bazë komunitare, etj.

TRAJNIME

Nr.	Qyteti	Data	Vendi	Nr. i pjesm	Tema
1	Berat	30.05.2022	ZOOM	22	“Të fuqizojmë dhe sigurojmë drejtësinë sociale për të zbutur pabarazitë e personave më vulnerabël”
2	Fier	02.06.2022	ZOOM	27	“Të fuqizojmë dhe sigurojmë drejtësinë sociale për të zbutur pabarazitë e personave më vulnerabël”
3	Elbasan	06.06.2022	ZOOM	26	“Të fuqizojmë dhe sigurojmë drejtësinë sociale për të zbutur pabarazitë e personave më vulnerabël”
4	Tiranë	10.05.2022	MAK	32	“Çështjet e diskriminimit të grupeve vulnerabël, praktika rajonale dhe kombëtare”
8 5	Tiranë	17.06.2022	Zyrat INSTAT	16	“Informimi i realizimit nga ana sasiore dhe cilësore në mbledhjen e të dhënave të komuniteteve më vulnerabël në veçanti atij Rom dhe Egjiptian, në kuadrin e realizimit të Cense 2022”

6	Tiranë	21.06.2022	XHEKO IMPERIAL	67	“Rehabilitimi dhe Reintegrimi i të burgosurve në prag lirimi në sistemin penitensiar”.
7	Tiranë	27.07.2022	ZOOM	18	“Portreti i një gjyqtari - një model shumëdimensional i kompetencave që do të maten gjatë procedurave të përzgjedhjes, vlerësimit dhe promovimit të gjyqtarëve”
8	Elbasan	11.10.2022	Elbasan	23	“Roli, efektiviteti dhe problemet që dalin nga zbatimi i legjislacionit të Gjendjes Civile, shtetësisë, azilit, për të huajt etj”
9	Korcë	12.10.2022	Korcë	32	“Roli, efektiviteti dhe problemet që dalin nga zbatimi i legjislacionit të Gjendjes Civile, shtetësisë, azilit, për të huajt etj”
10	Tiranë	26.10.2022	Mondial	27	“Roli, efektiviteti dhe problemet që dalin nga zbatimi i legjislacionit të Gjendjes Civile, shtetësisë, azilit, për të huajt etj” UNHCR
11	Tiranë	27.10.2022	Mondial	26	“Roli, efektiviteti dhe problemet që dalin nga zbatimi i legjislacionit të Gjendjes Civile, shtetësisë, azilit, për të huajt etj” UNHCR
12	Tiranë	28.10.2022	Mondial	21	“Roli, efektiviteti dhe problemet që dalin nga zbatimi i legjislacionit të Gjendjes Civile, shtetësisë, azilit, për të huajt etj” UNHCR
13	Durrës	04.11.2022	Bashkia Durrës	30	“Roli, efektiviteti dhe problemet që dalin nga zbatimi i legjislacionit të Gjendjes Civile, shtetësisë, azilit, për të huajt etj” UNHCR
14	Tiranë	26.10.2022	Mondial	46	“Të fuqizojmë dhe sigurojmë drejtësinë sociale për të zbutur pabarazitë e personave më vulnerabël” UNDP
	TOTALI			391	

3/1 Grupi i ekspertëve të TLAS gjate vitit 2022 ka draftuar:
“UDHËZUES PËR PËRCAKTIMIN E STATUSIT TË REFUGJATIT”

Ky udhëzues që synon të jetë sa më praktik, është përgatitur bazuar në metodologjinë e zbatimit efektiv të a) Konventës së vitit 1951 për Statusin e Refugjatit dhe të Protokollit të 19671 , dy prej instrumentave themelor për trajtimin e mbrojtjen e refugjatëve, të cilët braktisin vendet e tyre si rezultat i persekutimit, konflikteve dhe dhunës serioze të të drejtave të njeriut; b) të Udhëzimeve të EUAA, European Union Agency for Asylum (ish EASO: European Asylum Support Office)² që synojnë rritjen e rolit të punonjësve të ngarkuar me kontaktin e parë për aksesin në procedurën e azilit, për t’i garantuar kërkuuesve të drejtat themelore, përmes informacionit dhe orientimit drejt procedurave të përshtatshme dhe autoriteteve kompetente, që ata të dallojnë aplikantët e mundshëm për mbrojtje ndërkombëtare apo për procedura të mëtejshme e të ndërmjetme; c) të zbatimit të Ligjit 10/2021 ‘Per Azilin ne Republiken e Shqiperise’ dhe akteve nënligjore përkatëse dhe jo vetëm.

Komentari i plote gjendet ne www.tlas.org.al

HISTORI TE VËRTETA

Fëmijë që u mohohet e drejta për shkollim, duke qenë që nuk figurojnë si të regjistruar në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile.

Rasti i fëmijës me initiale S.T – 8 vjeç, i paregjistruar në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile, të cilin e identifikua si rast në Krujë, gjatë takimeve ‘*Street Laë*’ që Shërbimi Ligjor Falas Tiranë (TLAS) ka zhvilluar në këtë qytet. Nëpunësit e Gjendjes Civile si dhe punonjësi për mbrojtjen e fëmijeve, na e treguan më specifikisht për rasti si dhe për problemet që kishte kjo familje.

Fëmija i përkiste datëlindjes 16.07.2013, i lindur në qytetin e Krujës. Në kohën kur fëmija ka lindur, prindërit kanë qenë të pacelebruar. I porsalindur, fëmija është braktisur nga nëna, e cila u largua duke u martuar me një shtetas maqedonas – prej të cilit ka marrë dhe mbiemrin e tij. Gjendur në këto kushte, nga largimi i nënës së fëmijës dhe me mungesën e martesës ligjore është bërë i pamundur procesi i regjistrimit të tij, sipas ligjit të gjendjes civile. Për gjithë këto vite babai dhe gjyshja, kanë bërë përpjekje të vazhdueshme, por pa sukses. Të ndodhur në këto kushte, kërkuësit iu drejtuan TLAS për të marrë shërbim ligjor falas për vërtetimin e faktit juridik të lindjes së fëmijës.

Së pari, ju kërkua zyrës së Njesisë Administrative Krujë, të dërgojë njoftimin e parë me shkrim drejtuar nënës së fëmijës për t’i kujtuar zyrtarisht detyrimin ligjor të paraqitjes personalisht përpara zyrës së gjendjes civile për regjistrimin e fëmijës të saj. Nga informacionet e të afërmëve, rezultoi që nëna ndodhej në Maqedoni. Kështu që, pas kalimit të afatit prej 20 ditësh, as nëna apo asnjë përfaqësues nga ana e familjes së nënës nuk u interesua apo u paraqit për të regjistruar fëmijën, duke u bazuar në *Ligjin Nr.69/2018 “Për Gjendjen Civile”, të ndryshuar, në nenin 9 pika 31 cili thotë: “Nëse regjistrimi i lindjes së fëmijës nuk kryhet brenda 60 ditëve nga dita e lindjes, nëpunësi i gjendjes civile informon njësinë për mbrojtjen e fëmijës, pranë njësisë vendore, e cila ndërmerr veprimet konkrete për vlerësimin e situatës dhe regjistrimin e lindjes në zyrën e Gjendjes Civile.”* – u kontaktua Punonjësi për Mbrojtjen e Fëmijës në Krujë të cilit ligji i jep

të drejtën të kërkojë dhe asistojë deri në përfundim regjistrimin e lindjes së S.T.

Së dyti, pasi përfundoi regjistrimi i fëmijës në emrin e nënës nëpërmjet procedurës administrative, sic dhe e parashikon dispozita ligjore përkatëse, avokatja e Shërbimit Ligjor Falas (TLAS) Tiranë, Rudina Brari, hartoi kërkesën për njohjen e atësisë të fëmijës me initiale S.T. Njohja e atësisë u bë përmes procedurave gjyqësore, nga ku, TLAS, duke marrë parasysh gjendjen e vështirë ekonomike në të cilën familja ndodhej, mbuloi kostot e avokatit, të shpenzimeve gjyqësore e noteriale si dhe edhe ekspertizën shkencore të ADN's. Njohja e atësisë siguron në të njëjtën kohë edhe kujdestarinë ligjore, gjë të cilën deri më sot babai e kishte ushtruar "de facto" por jo "de jure", për 8 vite radhazi. Njohja e atësisë dhe si rrjedhim kujdestaria ligjore e fëmijës passjell edhe një mbështetje ekonomike të konsiderueshme për një prind i cili deri më sot nuk ka përfituar asnjë të ardhur nga programet përkatëse sociale.

Fëmijës i është mohuar përveçse e drejta për t'u shkolluar, e drejta për të marrë shërbim shëndetësor por dhe e drejta për të përfituar nga këto programe sociale, prandaj, me asistimin e rastit nga ana jonë, S.T mund të gëzojë tani e tutje të drejtën për të pasur një emër, të drejtën për t'u arsimuar, të drejtën për të marrë shërbim shëndetësor si dhe të gjitha të drejtat që i njeh ligji duke qenë shtetas shqiptar.

Avokate: Rudina Brari

Historia e nje 45-vjecari i cili nuk figuron si i regjistruar ne RKGJC dhe të cilit i janë mohuar për katër dekada, e drejta për të pasur një emër, e drejta për të përfituar nga shërbimet sociale e shëndetësore, e drejta për të qenë shtetas shqiptar etj

Lindja e A.K, nuk është regjistruar më parë, gjë e cila ka sjellë që ky person të mos posedojë asnjë dokument personal.

A, erdhi në jetë nga një lidhje jashtëmartesore dhe nëna M.H e braktisi kur ishte vetëm 5 muajsh. Që atëherë personi u rrit nga halla e tij duke jetuar në një zonë e quajtur Ura Vajgurore (guri i bardhë). Përafërsisht rreth viteve 1977- 1992 halla e ka shfrytëzuar duke e nxjerrë në rrugë të lypte. Në momentin që halla ka ndërruar jetë, A.K (kur ishte vetëm 15 vjec), zhvendoset duke jetuar në baraka në Durrës, Shkozet (Ura e Dajlanit).

Përgjatë periudhës 5-vjeçare në të cilën A.K jetoi në këtë zonë u njoh me xhaxhallarët dhe dy

motrat të cilat i treguan se nëna e tij biologjike ishte M.H dhe babai P.S.

Menjëherë pasi na u bë i ditur ky informacion, ekspertet e TLAS, shkuan në zonën ku jetonte A.K, për të kontaktuar njërën nga motrat që të merrnim më tepër informacion mbi nënën e A.K sa i përket vendbanimit të saj. Pasi motra na bëri me dije se nëna e tyre aktualisht banonte në Fier në zonën e quajtur Mbrostar Ura, vajtëm me të në banesën e M.H.

Si fillim M.H nuk pranonte se përreth viteve 1973-1978 ka lindur një djalë.

Bazuar në Nenin 41/1 të Ligjit. 10129 të datës 11.05.2009 "Për gjendjen civile" pikës 2 dhe 4 të VKM nr.288, datë 10.04.2020 dhe referuar Udhëzimit nr.10 datë 25.02.2015 'Për mënyrat, format e bashkëpunimit dhe procedurat e ndërhyrjes në ndihmë të fëmijëve në rrezik për institucionet dhe strukturat kryesore përegjegjëse për mbrojtjen e fëmijës', për të bërë të mundur vazhdimin e procedurës për regjistrim u detyruam si organizatë të drejtonim disa shkresa me lëndë 'Kërkesë për Informacion' Spitalit Obstetrik-Gjinekologjik të Kucovës, Fierit dhe Beratit të cilëve iu kërkuam fotokopje të Kartelës Klinike obstetrike dhe

çertifikatë të asistencës së lindjes për A.K.

Përgjigjja që morëm ishte se në asnjërin prej këtyre spitaleve përgjatë viteve 1973-1978 A.K nuk figuron si i regjistruar në regjistrat e maternitetit.

Për këtë arsye cështjen vendosëm ta ndiqnim gjyqësisht referuar:

Nenit 388 të Kodit të Procedurës Civile "Kur një fakt varet nga lindja, ndryshimi ose shuarja e të drejtave personale apo pasurore të një personi dhe akti që vërteton atë të zhdukur, ka humbur dhe nuk mund të bëhet përsëri pse nuk mund të merret me ndonjë rrugë tjetër, personi i interesuar ka të drejtë të kërkojë që fakti të vërtetohet me vendim të Gjykatës së Shkallës së Parë"; gjithashtu,

Nenit 38/2 të ligjit nr.10129 datë 11.05.2009 "Për Gjendjen Civile" i ndryshuar i cili parashikon "Në mungesë të dokumentacionit të përmendur në pikën 1 të këtij neni, vërtetimi i faktit të lindjes mund të provohet edhe nëpërmjet gjykatës".

Ndaj, shkuam përsëri në banesën e M.H së bashku me motrën e A.K, nga e cila kërkuam një prokurë për nisjen e procedurave ligjore. Përveçse arritëm të merrnim prokurën për vazhdimin e cështjes gjyqësisht, M.H, e ndihmuam, që të pajisej me mjet identifikimi duke qenë që kjo e fundit kishte probleme nga ana ekonomike.

Pas depozitimit të kërkesëpadisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, si dhe pas kryerjes së tri seancave gjyqësore, të përfaqësuara nga avokatja e TLAS Rudina Brari - eksperte e regjistrimit të shtetasve të Republikës së Shqipërisë - u arrit të kryhej regjistrimi i shtetasit lindur midis viteve '70 - '80 me initiale A.K.

Përveçse shtetasi A.K të regjistrohej në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile, gjithashtu tani ai mund të gëzojë një sërë të drejtash të tjera (të mohuara për mbi 40 vite radhazi) si: e drejta për të patur një emër; për të marrë shërbim shëndetësor dhe të gjitha të drejtat e tjera të cilat ligji i njeh duke qenë shtetas/e shqiptar/e i/e këtij vendi.

Avokate: Rudina Brari

MGJ ka lindur më 13.03.2005. Aktualisht jeton në fshatin Arbanë të Njësisë

Administrative Vaqarr me babain e saj biologjik FD dhe dy vëllezërit nga babai. Fëmija MGJ nuk është e regjistruar në regjistrin kombëtar të gjendjes civile. Babai i vajzës nga martesë e tij e parë ka dy djem 20 vjec dhe 15 vjec, ndërkohë pasi është ndarë nga bashkëshortja e tij e parë, ka nisur bashkëjetesën me nënën e vajzës që sipas tij nisur nga akti i lindjes që disponon Materniteti i ri i Tiranës është LB.

Kur FD është njohur me nënën e vajzës kanë qenë të dy të martuar ligjërisht. Për dy vite e gjysmë LV ka bashkëjetuar me FD për një periudhë kohore prej dy vitesh e gjysmë, periudhë në të cilën ka lindur fëmija MGJ e cila u regjistrua në gjendjen civile kur ka arritur moshën 14 vjec, me baba të prezumuar GGJ pasi nëna e fëmijës LV nuk e kishte zgjidhur ende martesën me GGJ në atë kohë. Kur fëmija ishte 4-muajsh LV u largua nga banesa (duke ia lënë fëmijën e porsalindur FD) për arsye se FD vazhdonte të ishte i martuar me AD (martesë e cila përfundoi me vendim të gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë). Gjithashtu, martesë e LV (nënës së fëmijës) e lidhur me GGJ ka përfunduar me divorc pas tri vitesh nga lindja e vajzës. Për rreth 14 vite, vajza mbeti e paregjistruar në zyrën e gjendjes civile, pasi nëna e saj nuk paraqitej për të bërë deklarinimin. Vetëm falë TLAS (Shërbimit Ligjor Falas) u arrit të realizohej regjistrimi i vajzës në RKGJC. Fëmija u regjistrua në zyrën e gjendjes civile më datë 15.05.2019 me baba të paditurin GGJ (personi i cili ishte i martuar nëna biologjike në kohën e lindjes së fëmijës).

Duke qenë që afati i parashikuar për të bërë kundërshtimin e atësisë është 1 vit nga

momenti i regjistrimit ne RKGJC të fëmijës, TLAS, mori përsipër të bënte dhe kundërshtimin e atësisë falas.

Aktualisht ndodhemi 3 vite nga momenti kur është depozituar kërkesëpadia në Gjykatë, dhe ende nuk ka përfunduar procesi gjyqësor për kundërshtimin e atësisë në mënyrë që fëmija të regjistrohet me baba biologjik FD. Kjo ka ardhur si shkak që nuk gjendet nëna biologjike e fëmijës pra nuk ka një adresë të saktë të saj.

Avokate: Rudina Brari

Rasti i fëmijës MB u referua pranë Zyrës së Shërbimit Ligjor Falas Tiranë - TLAS nga Njësia për Mbrojtjen e Fëmijës pranë Njesisë Administrative nr.4, Tiranë.

LSH është gjyshja e fëmijës së mitur MB i dtl. 19.08.2020. Fëmija i mitur ka ardhur në jetë nga një lidhje jashtëmartesore e vajzës së LSH.

Nëna e fëmijës shtetësja MB është diagnostikuar me: “Ataksite e trashëguar”, dhe për këtë trajtohet me pagesë të aftësisë së kufizuar, ndërsa babai i fëmijës nuk ja ka njohur atësinë, fëmija është pa atësi dhe për këtë ka përfituar statusin e jetimit, në datë 07.12.2020.

Që nga lindja e fëmijës për të është kujdesur gjyshja, LSH, sepse nëna e fëmijës është e paaftë për t’u kujdesur për fëmijën për shkak të gjendjes së saj shëndetësore. Vetë nëna ka nevojë për kujdes të vazhdueshëm.

Praktikisht, edhe pse për fëmijën kujdesej gjyshja, fëmija ligjërisht kishte mbetur pa një kujdestar ligjor i cili të kujdesej për fëmijën dhe interesat e tij.

Neni 2 i Kodit të Familjes parashikon: “Prindërit, organet kompetente dhe gjykatat, në vendimet dhe veprimtarinë e tyre, duhet të kenë si konsideratë parësore interesin më të lartë të fëmijës.”

Neni 263 i Kodit të Familjes parashikon rastet e vendosjes së fëmijëve në kujdestari:

“Fëmijët e mitur vendosen në kujdestari dhe gëzojnë mbrojtje të veçantë nga shteti kur prindërit e tyre janë në pamundësi për të ushtruar përgjegjësinë prindërore, për shkak se të dy prindërit kanë vdekur ose nuk njihen, janë shpallur si të pagjetur, u është hequr përgjegjësia prindërore ose u është hequr zotësia për të vepruar, si dhe për çdo shkak tjetër të pranuar nga gjykata.”

Në rastin konkret bazuar në nenin e sipërcituar, paaftësia e nënës së fëmijës dhe fakti që atësia e fëmijës nuk njihet, janë shkaqe të parashikuara edhe nga ligjvënësi për t’u vendosur fëmijët në kujdestari. Nëna e fëmijës, për shkak të gjendjes së saj shëndetësore, nuk mund ta ushtrojë përgjegjësinë prindërore ndaj fëmijës dhe për këtë fëmijët duhet të vendosen në kujdestari të një personi i cili është i aftë të kujdeset për të dhe t’i sigurojë të gjitha nevojat e fëmijës, qoftë materiale, shpirtërore, sociale duke i siguruar një ambient të pershtatshëm për mirërritjen e tij.

Ligjvënësi parashikon një mbështetje financiare të ofruar nga shteti për të gjitha rastet e vendosjes në kujdestari si një mënyrë për të mbështetur familjen në përmbushjen sa më mirë të nevojave të fëmijës.

Rasti i zgjidh më së miri, fëmija u vendos në kujdestarinë e gjyshes dhe tashmë fëmija ka një kujdestar ligjor për mbrojtjen e interesave të tij. Në këtë mënyrë u arrit të realizohet një nga parimet bazë të kodit të familjes në të cilën duhet të bazohen të gjitha vendimet gjyqësore në të cilën janë të përfshirë të mitur, interesi më i lartë i fëmijës.

1. Ekspertiza e TLAS në Takimet e Grupve Ndërsektoriale

Gjatë vitin 2022 bashkëpunimi me grupet ndërsektoriale ka qënë shumë intesiv. Stafi I TLAS ka marrë pjesë në 9 takime të grupeve teknike ose të GTN've. Gjatë këtyre takimeve që janë organizuar nga Punonjësit për mbrojtjen e femijeve nga Njësitë Administrative në Tiranë janë diskutuar shumë problematika të ndryshme pranë familjeve të cilat kanë probleme te veshtira ekonomike.

Nr.	Date	Problematika	Organizuar
1.	28.04.2022	E.V sëbashku me katër fëmijët e saj jeton në Njësinë Administrative Nr.11. Pas daljes nga qendra e riintegritimit familja mbështetet dhe monitorohet në mënyrë të vazhdueshme nga PMF 11 dhe PMF 9 në bashkëpunim me CVE dhe TDH të cilët lehtësojnë procedurat dhe ofrimin e shërbimeve direkte për fëmijët dhe familjen. Deri tani, bazuar në PIM e datës 31.02.2022 familjes i janë ofruar këto shërbime: paisje me divana, frigorifer, sobë gatimi, enë kuzhine, krevat marinari dhe dy dysheke, paketa ushqimore për muajin shkurt-maj, vazhdimi i vaksinimit, mbarvajtja e vajzave në shkollë dhe rregjistrimin e fëmijëve më të vegjël në çerdhe dhe kopësht, pagesa e kopështit, medikamente për fëmijët me të vegjël. Në vijim detyrat që u lanë për mbështetjen e rastit janë: Monitorim periodik i fëmijëve/familjes - PMF 11+PMF 9 - Ndjekja në vazhdimësi e procedurës së rregjistrimit të fëmijëve të lindur në Siri - TLAS - Mbështetja me paketë ushqimore - TDH - Mbështetja me paketë higjenike&pampersa - TDH - Psikologia e rastit të jap nje fidbek për mbarvajtjen psikologjike të fëmijëve për PMF, pasi është në interesin me të lartë të fëmijëve, (CVE), (TDH) - Kurs rrobaqepsie për shtetasen Entela Vladi (TDH).	Njësia për mbrojtjen e fëmijës, NJMF e Njësisë Administrative Nr.11, Tiranë
2. 14	13.05.2022	GTN e Durrësit u mblodh për të diskutuar rastin e një të miture me initiale ZÇ, ka lindur nga bashkëjetesa midis GÇ dhe SY, në maternitetin e Durrësit. Babai me initiale GÇ, ka jetuar ne Durrës, ndërsa mamaja	Njësia për mbrojtjen e fëmijës, NJMF e Njësisë

15	SY, ka qenë banore e Shkodrës. Pasi nisën të bashkëjetonin, nëna e vajzës zhvendoset në Durrës mirëpo me gjendjen civile vazhdon të ishte ende banore e Shkodrës. Në vitin 2008 lind fëmija ZÇ, por për arsye se dy shtetasit ishin të pazelebruar së bashku, fëmija duhej të regjistrohej me të dhënat e nënës. Gjë që nuk u arrit as kjo, pasi për shkaqe të pamundësisë ekonomike nëna nuk mundi të lëvizte nga qyteti ku banonte (Durrës), në atë ku figuronte si e regjistruar (Shkodër) për të bërë regjistrimin e vajzës. Të dy prindërit kanë qenë konsumues të rregullt të pijeve alkoolike. Gjë e cila u bë shkak që nëna e vajzës të vuante nga një sëmundje në mëlçi (ceroza), e cila i mori dhe jetën. Që nga ky moment, vajza fillon të jetojë vetëm me babanë e prezumuar, pasi duke qenë që ky i fundit, nuk ishte i martuar me SY, GÇ, nuk njihej si babai biologjik i saj. Më tej, GÇ njihet dhe bashkëjeton me dikë tjetër e cila dhe pse jo nëna biologjike e vajzës, e trajton atë si të ishte e tillë. Pas disa vitesh babai dhe njerka zgjedhin të mos bashkëjetojnë më, mirëpo marrëdhëniet midis vajzës dhe njerkes, vazhdojnë të ruhen si në fillim. Madje kjo e fundit ka qenë një ndër personat e cila përveçse ka referuar rastin e vajzës për regjistrim, ka ndjekur gjithashtu, hap pas hapi procedurat për regjistrimin e saj. Familjarët, pas insistimeve të njëpasnjëshme, kanë tentuar për vite me radhë të bënin regjistrimin e saj, por nuk kanë arritur për shkak se materniteti nuk lëshonte si dokument çertifikatën e asistencës së lindjes - të cilin e kanë detyrim ligjor - i domosdoshëm për regjistrimin e vajzës. Gjendur përballë dy fakteve, nënës së vajzës e cila kishte ndërruar jetë dhe një babai i cili prezumohej si i tillë, rasti u asistua nga TLAS, për të marrë shërbim ligjor falas për vërtetimin e faktit juridik të lindjes së fëmijës. Përpos ndihmës ligjore të ofruar falas për një rast që i përket një prej komuniteteve më vulnerabël, TLAS mbuloi dhe shpenzimet e ekzaminimit të ADN-së për rastin në fjalë. Duke qenë se ky rast ka mungesë të theksuar dokumentesh, duhej realizuar dhe raporti i analizës së testit të atësisë për ZÇ. Përmes ekzaminimeve me tampon pështymë u krijuan profilet gjenetike, për të paraqitur lidhjet familjare baba-bijë. <i>Me ndihmën e TLAS, u arrit që vajza të regjistrohej në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile, gjë e cila u pasua nga gëzimi i një sërë të drejtash të tjera si: e drejta për të patur një emër; për t'u arsimuar; për të marrë shërbim</i>	Administrative Durrës.
----	---	------------------------

		<i>shëndetësor dhe të gjitha të drejtat e tjera të cilat ligji i njeh duke qenë shtetas/e shqiptar/e i/e këtij vendi.</i>	
3.	25.05.2022	GTN u mbledh për të vendosur se kush do të merrte përsipër përfaqësimin e një rasti kujdestarie në gjykatë. Femijët e mitur përkatësisht AB 11 vjec, DB 8 vjec dhe S.B 4 vjec. Të cilëve u kishin ndërruar jetë prindërit në një aksident automobilistik dhe aktualisht jetonin me hallën, pa asnjë mbështetje ekonomike. TLAS, mbështeti familjen që të ndiqte falas rastin gjyqesisht në gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.	Njësia për Mbrojtjen e Fëmijës, NJMF, e Njesisë Administrative Nr.8 Tiranë
4.	10.06.2022	GTN u mbledh për rastin e një gruaje të dhunuar në mënyrë sistematike e cila kishte lidhur martesë me AA në vitin 2013. Nga kjo martesë kanë lindur dy fëmijë. Nëna e fëmijëve EA e ka denoncuar së fundmi dhunën që i është ushtruar nga bashkëshorti, dhe i kanë dhënë vetëm urdhër mbrojtjeje. Ajo ndihet e kërcënuar pasi nuk ka banesë ku të jetojë vetëm me fëmijët e në këto kushte është e detyruar të vazhdojë të jetojë nën një cati me dhunuesin.	Njësia për Mbrojtjen e Fëmijës, NJMF, e Njesisë Administrative Nr.3 Tiranë
5.	09.07.2022	GTN u mbledh për të diskutuar rastin e kujdestarisë për një të mitur me iniciale GF të cilës i kishin ndërruar jetë të dy prindërit. Kujdestarinë e saj kërkonte ta merrte i vëllai DF. I cili solli të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, pranë TLAS. TLAS, po e ndjek çështjen nga ana gjyqësore si dhe e ka vënë në kontakt familjen me organizata të cilat mund t'i vinin në ndihmë.	Njësia për Mbrojtjen e Fëmijës NJMF, e Njesisë Administrative, Kashar
6.	21.07.2022	Takimi nga GTN, mundësoi njohjen e gjendjes aktuale të rastit dhe situatës së të miturit SP e cili jeton në banesën e gjyshërve nga babai në territorin e Njesisë Administrative nr.5. I mituri ka 7 ditë që është larguar nga kjo banesë drejt Rrugës së Dibrës, ku kishte dhe shoqërinë e tij. SP është braktisur nga nëna që 1 vjec, atësia është e panjohur dhe kujdestarinë ligjore e ka vetëm e nëna e cila jeton në shtetin gjerman dhe ka familje tjetër. Më datë 28.02.2022 është gjendur nga komisarati nr.2 Tiranë në situatë rrugë, pasi ishte larguar nga banesa e gjyshërve duke qendruar vetëm në një dhomë dhe i shoqëruar me shokë me të mëdhenj se vetja. Në komisaratin nr.2 është asistuar nga Nisma/Arsis ku i mituri është	Njësia për Mbrojtjen e Fëmijës NJMF, e Njesisë Administrative, Nr.5

		akomoduar ne emergjencë , ku nuk deshiron te kthehet tek gjyshë rit nga ana e babait. Gjyshi AP pohon se nipi nuk e degjon dhe nuk mund ta kontrolloj. Gjyshja DP pohon se ne e duam po ai ka nje sjellje jo te mire dhe shoqerohet me shoqeri jo te mire pasi konsumon duhan dhe ndoshta dhe ndonje gje tjeter. <u>Grupi Teknik Ndersektorial në fund te takimit realizoi:</u> <u>Hartimin e Planit Individual te Mbrojtjes për fëmijën, të cilën në veçanti përcaktojnë:</u> • Komunikimi me nenen pasi eshte e vetmja kujdestare ligjore PMF/TLAS • Intervista formale (Drejtoria vendore e policise me kerkese te PMF)pasi i kemi te gjitha indiciet qe i mituri te jete VMT. • N/Specialist i policimit me komunitet Komisariati nr.3 do na informojne per hyrjet daljet e znj.MP nena e te miturit,per te bere proqedurat e njohjes se atesise te femijes.	
7.	28.02.2022	Ky rast është identifikuar në rrugë, lypësi, nga punonjeset e skuadrave të terrenit në Bashkinë Elbasan gjatë investigimeve në terren, gjithashtu dhe në territorin e Bashkisë së Tiranës. Familja është identifikuar në shtate lypje para shumë vitesh, dhe prej vitesh kanë marrë shërbime nga Bashkia Elbasan , por fakti që familja ka qenë në lëvizje të vazhdueshme nga qyteti në qytet, ka bërë që shërbimet të mos jenë të qëndrueshme dhe efikase. Djali i madh i familjes, Celiku bashkëjeton me DS (banore e Tiranës), prej 6 vitesh,bashkëjetesë nga e cila kanë ardhur në jetë 2 fëmijë, përkatësisht A. 3 vjec dhe M 2 vjec, të cilët janë të regjistruar në certifikatën familjare të Denadës, pasi prindërit nuk kanë martesë të zyrtarizuar, DS është serish shtatëzënë në 8 muaj ku pretendon se e ka me Z.Celik i cili e ka braktisur prej disa muajsh. Aktualisht ka krijuar një marrëdhënie tjetër me një person tjetër po kanë vështirësi pasi nëna e djalit nuk e pranon me fëmijët në shtëpi, ato gjenden në situatë rruge dhe nuk ka mundësi ekonomike , nëna e saj nuk e mbështet për marrëdhënien e re e kundërshton pasi duhet që të rrijë të rrisë fëmijët por znj. DS nuk pranon të ndahet dhe të jetojë vetëm me fëmijët e saj. Disa herë ka tentuar t'i braktisë fëmijët dhe mos të kthehet	Njësia për Mbrojtjen e Fëmijës NJMF, e Njesisë Administrative, Nr.11

		më për ta.	
8.	30.09.2022	Strukturat e mbrojtjes së fëmijës në bashkinë Tiranë janë përfshirë në procesin e menaxhimit të rasteve të kthyer nga zonat e konfliktit. Procesi riintegrimi të rasteve të kthyer nga zonat e konfliktit është ndërtuar bazuar në një metodologji pune duke vendosur në qender fëmijën. Punonjëset e Mbrojtjes së Fëmijëve në bashkëpunim me institucionet të cilat janë pjesë e tryezave teknike ndërsektorale (arsim, shendetesi, polici, organizata të shoqërisë civile, qendra sociale) për secilin prej fëmijëve kanë hartuar plane individuale mbrojtjeje për ta dhe familjet e tyre me qëllim riintegrimin dhe monitorimin e vazhdueshëm. TLAS, ka kontribuar në nxjerrjen e mjeteve të identifikimit (karta identiteti).	Njësia për Mbrojtjen e Fëmijës NJMF, Drejtoria e Përgjithshme e Sherbimeve Sociale
9.	18.08.2022	Më datë 17.08.2022, Njësia për Mbrojtjen e Fëmijës pranë Bashkisë Tiranë ka aplikuar masën emergjente të mbrojtjes për dy të miturit MG dhe AG - fëmijë në nevojë për mbrojtje për shkak se gjenden pa kujdes prindëror pasi nëna ndodhet jashtë Shqipërisë (Turqi) dhe i ati nuk lejohet nga gjyshja e fëmijëve të ketë kontakt me fëmijët.	Njësia për Mbrojtjen e Fëmijës NJMF, Tiranë